



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 128/15 Prot.

Tiranë, më 31/05/2016

V E N D I M

Nr. 59, Datë 31/05/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË KONISPOL, SARANDË "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimin e administrimin e aseteve të qëndrueshme", të ushtruar në Bashkinë Konispol, Sarandë, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Për Bashkinë Konispol

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol paraqet *fatura të pa likuiduara* deri më datë 31.7.2015 në vlerën 31,428,337 lekë, ndërsa deri më datë 31.12.2015 paraqet vlerën **60,446,245 lekë**, ku peshën kryesore në masën 95 % e zënë *energji elektrike* e mbartur në vite (2009-2015), vlerë e cila do të rëndojë në buxhetin e vitit 2016 krahas likuidimeve të radhës.

Rekomandimi: Bashkia Konispol për vitin 2016 të marrë masa që të kursejë dhe të reduktojë shpenzimet, të arkëtojë të ardhurat vendore, të vjelë vlerat debitorë si dhe të shikojë çdo mundësi tjetër me miratim të Këshillit Bashkiak, me qëllim që të shlyej borxhin publik për vlerën 60,446,245 lekë ndaj të tretëve.

Në Vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol ***nuk ka kryer inventarin e pasurisë për vitin 2015, për njësinë administrative Xarrë dhe Markat si dhe Bashkia Qendër***, në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 53, datë 15.12.2015 dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik të njësisë administrative Xarrë dhe Markat si dhe Bashkisë Konispol.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol disponon ***2 automjete jo rentabël***, pasi për vitin 2013, 2014 dhe 2015 Mjeti tip “Benz” në përdorim të administratës me targë SR7319B dhe kamioni i pastrimit paraqet shpenzime karburanti të përafërta (*1,6 milion lekë*) me vlerën fillestare të tyre (*1,8 milion lekë*). Gjithashtu disponohen normativa të larta të harxhimit të karburantit, përkatësisht për Benzin *14 litra/100 km* dhe kamionin *17 litra/ 100 km*, të cilat nuk janë rifreskuar për periudhën nën auditim, pasi janë në fuqi normativat e vitit 2011, sipas Vendimit të Këshillit Bashkisë nr. 40, datë 7.12.2011. Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” dhe me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit*”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol për vitin 2016 të marrë masa për miradministrimin e Benzit të administratës dhe kamionit të pastrimit, duke rivlerësuar normativat e harxhimit të karburantit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Planifikimi nga zyra e taksave vendore e Bashkisë Konispol nuk është i shoqëruar me asnjë analizë, argument, të dhëna të detajuara mbi bazën e të cilave duhet të jepeshin shpjegime dhe llogaritje mbi faktin se si është shkuar në vlerën përfundimtare të planifikimit të ardhurave për secilën taksë dhe tarifë vendore. Kjo gjë do t'i jepte mundësi Bashkisë për të gjykuar mbi saktësinë e planifikimit të ardhurave, për të bërë korrektime të nevojshme, si dhe do ti jepte mundësi vet sektorit të ardhurave të ulte rrezikun e gabimeve në planifikim. Nga këto veprime janë shkaktuar ***të ardhura të munguara*** për buxhetin e Bashkisë në shumën ***15,186,047 lekë***, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.6.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Konispol të marrë masa për analizimin, argumentimin, për disponimin e të dhënave të detajuara dhe të kryejë llogaritje mbi faktin për të planifikuar të ardhurat për secilën taksë dhe tarifë vendore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se ***gjendja e debitorëve*** më 31.12.2015 paraqitet në shumën ***6,066,551 lekë***, nga e cila në 35 raste nga biznesi Konispol në shumën 2.225.223 lekë, sipas tabelës nr. 2, në 3 raste nga biznesi i transportit në shumën 116.412 lekë, sipas tabelës nr. 1, në 45 raste në shumën 286.161 lekë nga fermerë të fshatit Çiflik, sipas tabelës nr. 3, bashkëlidhur, në 253 raste në shumën 2.721.075 lekë, fermerë të Bashkisë Konispol, sipas tabelës nr. 4, dhe debitorë tipikë për mospagimin e detyrimeve të ujit të pijshëm janë 52 persona në shumën totale prej 717.680 lekë, sipas tabelës nr. 5.

Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën **6,066,551 lekë**, nga kjo në 35 raste nga biznesi Konispol në shumën 2.225.223 lekë, sipas tabelës nr. 2 bashkëlidhur, në 3 raste nga biznesi i transportit në shumën 116,412 lekë, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur, në 45 raste në shumën 286,161 lekë nga fermerë të fshatit Ciflik, sipas tabelës nr. 3 bashkëlidhur, në 253 raste në shumën 2.721.075 lekë, fermerë të Bashkisë Konispol, sipas tabelës nr. 4 bashkëlidhur dhe debitorë tipikë për mospagimin e detyrimeve të ujit të pijshëm janë 52 persona në shumën totale prej 717,680 lekë, sipas tabelës nr. 5, bashkëlidhur.

Brenda vitit 2016

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol paraqet detyrime për **1 vendim gjyqësor** të Apelit Tiranë nr. 103 datë 8.11.2011, të fituar nga ish-punonjësi i saj G.D. **për largime nga puna**, çka ka shkaktuar pagesë të dyfishtë për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë **ndikim negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën 1,382,355 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 217, datë 20.10.2014 etj, për të cilën nuk ka dalë përgjegjësia ndaj personave fajtor dhe nuk ka masa administrative, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për rastin e pagesës të dyfishtë për të njëjtin vend pune, çka ka dhënë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën 1,382,355 lekë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol, në miratimet e strukturave organike të administratës për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk ka parashikuar strukturë të veçantë për administrimin dhe inventarizimin e gjendjes faktike dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të aseteve në administrim të Bashkisë, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, pika 9.

Rekomandimi: Bashkia Konispol brenda mundësive të marrë masa për krijimin e një strukture të veçantë apo caktimin e një personi për inventarizimin, regjistrimin në ZVRPP dhe administrimin e të ardhurave nga asetet dhe pronat e tjera të kësaj bashkie, duke përfshirë dhe bashkimin e aseteve dhe pronave të ish-Komunave Xarrë dhe Markat, pjesë të kësaj Bashkie nga zbatimi i reformës së ndarjes territoriale.

Brenda muajit Korrik 2016

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Konispol, ka marrë në pronësi pronë të paluajtshme rreth 686 ha të llojit kullotë dhe pyll, me VKM nr. 894, datë 11.6.2008, 3771 hektarë kullotë dhe pyll me VKM nr. 17, datë 04.01.2012, për të cilat nuk ka përfunduar procedura e regjistrimit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, për shkak të mbivendosjes së pronave të regjistruara si pronë private në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për vlerësimin faktik të pronave të transferuara, të shoqëruara me harta, skica dhe dokumenta shoqëruesë të tyre duke bërë inventarizimin fizik, si dhe zgjidhjen e çështjes së mbivendosjes me AKKP Tiranë dhe ZVRPP Sarandë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Janë regjistruar 395,72 ha kullotë dhe pyll pronë e Bashkisë Konispol në vitin 2015, në mungesë të programit nga titullari i Bashkisë Konispol për shfrytëzimin e tyre, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për

inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pika 22 dhe të UMF 30 datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” kap. IV “Sistemi periodik i aktiveve”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të hartojë programe për trajtimin e këtyre pasurive, vlerësimin e kapaciteteve kullimore nga ekspertë të licencuar, ngritjen e komisionit të vlerësimit të tyre dhe regjistrimit në kontabilitet.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Konispol, në 27 raste, u konstatua **mungesë të ardhurash nga qiratë e tokave bujqësore**, pronë e Bashkisë Konispol në shumën **491,535 lekë**, për vitet 2014 dhe 2015, në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe me ligjin 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë” neni 420 dhe neni 693 “Detyrimet lindin nga kontrata” si dhe me pikën V/2 të UKM nr. 1 datë 18.7.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të 27 fermerëve në shumën **491,535 lekë** duke bërë njoftimet përkatëse dhe kërkit në rrugë gjyqësore të zgjidhjes së kontratave.

Brenda muajit Shtator 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Konispol, në 2 raste janë dhënë me qira dy sipërfaqe troje nga fondi pyjor in-produktiv, respektivisht 20 m² me “V...E” dhe 200 m² me “A...C”, për instalimin e antenave të telefonisë celulare në kundërshtim me kërkesat e VKM nr 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, me afat kontrate mbi 1(një) vit, me referencë të gabuar ligjore, me mos arkëtim të qirasë në shumën **200,000 lekë si mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë**.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor të vitit 2015, në shumën **200,000 lekë** nga “V...E”. Të negociojë me Kompaninë “A...C” me qëllim rishikimin e afatit, kushtet dhe referencat ligjore për kontratat e lidhura.

Brenda muajit Korrik 2016

II. Për Njësinë Administrative Markat (ish-Komuna Markat).

12. Gjetje nga auditimi: Kontabiliteti dhe bilanci i ish-komunës Markat paraqet parregullsi, pasaktësi, mangësi të theksuara, dokumentacioni nuk është i sistemuar, nuk është i inventarizuar dhe arkivuar, ka mungesa dokumentesh, veprimet kontabël nuk janë kryer, etj.

a. Kështu për periudhën 2013, 2014, 2015 në ish-komunën Markat nuk janë mbajtur ditari i arkës, bankës, magazinës, ditari i veprimeve të ndryshme, libri i pagave, libri i magazinës, centralizatori apo libri i madh.

b. Bilanci i vitit 2014 është mbyllur në mënyrë ekstrakontabile (duke kryer veprime nga jashtë kontabilitetit) duke i marrë të dhënat nga sistemi i shpenzimeve në Thesar në formë evidence, sipas urdhër shpenzimeve, pra veprimet kontable nuk kanë kaluar në ditarët dhe në centralizator. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga jashtë nisur nga situacioni i shpenzimeve dhe jo nga rregjistrimi i veprimeve ekonomike në kontabilitet. Janë mbajtur llogarite sintetike të pa shoqëruara me regjistrat analitike të tyre. Mungon inventari kontabël i llogarive analitike dhe nuk është kryer inventari fizik i pasurisë.

c. Fatura të pa likuiduara të ish-komunës Markat deri më datë 7.7.2015 paraqiten në vlerën 4,334,807 lekë, ku shumica e tyre nuk shoqërohen me dokumente justifikuese si kontrata, urdhër prokurimi, procesverbale, fletëhyrje etj.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9298, datë 29.04.2004 “*Per kontabilitetin dhe pasqyrat financjare*” i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit piblik*”, pjesa “*Inventarizimi i aktiveve*” pika 74, me Planit Kontabel të Organeve të Pushtetit vendor i miratuar me VKM nr. 248, datë 10.01.1998.

Rekomadimi: Bashkia Konispol dhe Njësia Administrative Markat të marrë masa urgjente të sistemojë, inventarizojë dhe arkivojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Markat.

Brenda muajit Korrik 2016

13. Gjetje nga auditimi: U konstatua se është keq administruar Automjeti tip Benz e llojit ML 400 CDI, transferuar pa pagese nga Kuvendi sipas shkresës nr. 366 date 10.10.2011 dhe procesverbalit date 6.10.2011, pasi ky automjet nuk është i regjistruar në kontabilitet, nuk është vlerësuar me komision nga ish-komuna, nuk disponohen dokumentet e makinës targat, akt kolaudimi, leja e qarkullimit, pagesa e taksave, siguracioni etj. Gjithashtu automjeti nuk ndodhet fizikisht në Njësinë Markat por në ambiente private dhe pretendohet se është jashtë funksionit, çka nuk justifikohet me dokumente, pasi automjetit ka qenë në gjendje pune, këtë e faktojnë shërbimet e kryera dhe furnizimi i tij me karburant deri në korrik 2015, sipas faturës nr. 81 datë 30.6.2015 ku automjeti është furnizuar me 1400 litra karburant. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik*”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin*”, me ligjin ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol dhe Njësia Administrative Markat të marrë masa për administrimin e Automjetit **Benz ML 400 CDI**, duke e bërë hyrje, rivlerësuar me komision, zhvendosjen e saj nga ambientet private në bashki, për efekt të shfrytëzimit të saj për nevoja të bashkisë.

Brenda muajit Qershor 2016

14.Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Markat rezultoi se nuk ka ardhur vendimi i Këshillit të Ministrave, për listën përfundimtare të pronave të cilat do të kalonin në pronësi të kësaj Komune. Nga ish-drejtuesi i kësaj Komune nuk është i kërkuar në mënyrë shkresore institucioneve qendrore dokumentacioni (VKM) për listën e pronave duke sjellë pengesë në trajtimin e tyre.

Rekomandimi: Bashkia Konispol, Njësia Administrative Markat, të kërkojë në rrugë zyrtare listën përfundimtare të pronave të cilat janë miratuar me VKM nr. 1287, datë. 23.12.2009, “*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Markat, Qarku Vlorë*”.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në Njësinë Administrative Markat, nga verifikimi kontratave të qirave për tokat e lira rezultoi se janë debitorë nga viti 2012 për qiranë e papaguar të tokave, 6 persona për shumën totale 112,684 lekë, 13 persona të tjerë në shumë 90,712 lekë, të cilëve u ka kaluar afati i pagesës, në kundërshtim me UKM nr. 01, datë 18.7.2012 “*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*”, duke shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e ish-Komunës Markat në shumën **196,809 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Konispol Njësia Administrative Markat të marrë masa për arkëtimin e qirave të papaguara të tokave në shumën **196,809** lekë nga 19 persona (*lista bashkëlidhur*) debitorë ndaj ish-Komunës Markat.

Brenda muajit Korrik 2016

16. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

Rekomandim: Bashkia Konispol, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marri masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Brenda muajit Gusht 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Kreu V, nenet 9-14 dhe Kreu VII-të- Funksioni dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e kryetarit të Bashkisë Konispol** të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekezekutive) dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 92,464,818 lekë**, nga kjo:

a. 42,825,135 lekë dëm ekonomik,

b. 49,639,683 lekë, dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve.

I. Bashkia Konispol paraqet një dëm ekonomik në vlerën 18,627,432 lekë.

1. Gjetje nga auditimi: 22 Këshilltar të Bashkisë kanë përfituar pagesa të paligjshme për vlerën **923,515 lekë dëm ekonomik**, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli për vitin 2013, 2014 dhe 2015, sipas protokollit të mbledhjeve të Këshillit Bashkisë Konispol dhe borderove (listpagesave) përkatëse, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” kreu VI, neni 29, pika 2 si dhe me nenin nr. 31, pika 2 dhe 8.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa dhe të kryej arkëtimin e vlerës **923,515 lekë** për **pagesa të paligjshme të 22 këshilltarëve** të Bashkisë Konispol, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli, për vitin 2013, 2014 dhe 2015, ndërsa janë paguar padrejtësisht, përkatësisht: A.A. 118,979 lekë, A.S. 109,261 lekë, B.T. 69,530 lekë, E.S. 94,577 lekë, T.A. 59,531 lekë, V.T. 59,151 lekë, J. K. 59,630 lekë, F.S. 34,765 lekë, Z.Z. 56,388 lekë, A.S. 54,399 lekë, M.L. 4,950 lekë, B.SH. 19,915 lekë, J.M. 27,028 lekë, K.S. 27,028 lekë, E.M. 27,028 lekë, F.B. 33,785 lekë, A.B. 20,271 lekë, B.M. 27,028 lekë, J.K. 6,757 lekë, F.A. 6,757 lekë, E.D. 6,757 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013, 2014 dhe 2015, ish-kryetarja e Bashkisë ka përfituar mbi normativën ligjore shpenzime celulare për vlerën **73,971 lekë dëm ekonomik**, pasi ka përfituar padrejtësisht mbi kufirin ligjor 4,000 lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 17, datë 26.01.2015 , nr. 29, datë 16.02.2015, nr. 72, datë 20.4.2015, nr. 98, datë 22.5.2015 , nr. 118, datë 18.6.2015, nr. 147, datë 20.7.2015 , nr. 173, datë 24.8.2015, nr. 198 datë 15.9.2014, nr. 222 datë 20.10.2014, nr. 238 datë 17.11.2014, nr. 272, datë 16.12.2014 et, sipas procesverbalit rakordues datë 18.02.2015 dhe datë 18.02.2014 etj, në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “*Për pajisjen me numër telefoni celularë të personave juridikë, publikë*”, pika 9 dhe me VKM 589, datë 5.9.2012 ‘*Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore*’ pika 2 (Trajtuar në faqet 31-34 të Raportit të Auditimit).

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **73,971 lekë**, nga M.A., ish-Kryetare e Bashkisë, për tejkalim normative të shpenzimeve celulare, për vitin 2013, 2014 dhe 2015.

Brenda muajit Gusht 2016

3. Gjetje nga auditimi: U konstatua vlera **38,000 lekë dëm ekonomik** shpenzimi i pajustificuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 196, datë 15.9.2014, për gjërmim e transport dheu 60 m3 rruga Postbllok-Konispol, pasi nuk ka projekt, nuk ka fotografime para punimeve dhe pas punimeve, nuk ka përmasime të kanalit për efekt të justifikimit të 60 m3 dhe nuk ka kërkesë të sektorit shërbimeve dhe miratim të saj, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **38,000 lekë**, nga përgjegjësjë e shërbimeve T.Ç. shpenzimi i pajustificuar, sipas urdhër shpenzimit nr. 196, datë 15.9.2014, për gjërmim e transport dheu 60 m3 rruga Postbllok-Konispol, pasi nuk ka projekt, nuk ka fotografime para punimeve dhe pas punimeve, nuk ka përmasime të kanalit për efekt të justifikimit të 60 m3 dhe nuk ka kërkesë të sektorit shërbimeve dhe miratim të saj.

Brenda muajit Korrik 2016

4. Gjetje nga auditimi: U konstatua vlera **106,250 lekë dëm ekonomik** mungesë inventari 1 Laptop HP, për ish-kryetaren, sipas urdhër shpenzimit nr. 263, datë 10.12.2014 dhe fletëhyrjes të bashkisë nr. 32, datë 30.10.2014, pasi nuk është dorëzuar nga ish-kryetarja e bashkisë, sipas procesverbalit të komisionit datë 3.8.2015 dhe shkresës nr. 560 datë 02.09.2015 të bashkisë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **106,250 lekë**, nga M.A. për mungesë inventari 1 Laptop HP pasi nuk është dorëzuar nga ish-kryetarja e bashkisë, sipas fletëdaljes nr. 2, datë 24.2.2016, procesverbalit datë 03.8.2015 dhe shkresës nr. 560 datë 02.09.2015 të bashkisë.

Brenda muajit Korrik 2016

5. Gjetje nga auditimi: U konstatua vlera **189,360 lekë dëm ekonomik**, për tejkalim normativave të karburantit të mjetit tip “Benz” në përdorim të administratës me targa SR7319B, sipas rekordimit të fletudhëtimeve me sasinë e furnizuar dhe me normativat e miratuara, konkretisht: për vitin 2013 nga 3,208 litra furnizim sipas fletëdaljeve justifikohen 2,694 litra për 19,245 km gjithsej, pra *diferenca e pajustificuar (3208-2694) 514 litra* x180=92,520 lekë dhe për vitin 2014 nga 4,152 litra furnizim sipas fletëdaljeve justifikohen 3,614 litra për 25,814 km gjithsej, pra *diferenca e pajustificuar (4152-3614) 538 litra* x180=96,840 lekë. Për vitin 2015 nuk mund të kryhet rekordimi pasi karburanti është bere dalje i përbashkët për 2 makinat. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e Aktiviteteve në Njësinë e Sektorit*”.

Publik” dhe me ligjin nr. 10279, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollit”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **189,360 lekë**, nga shoferi **D.Z. 94,680 lekë** dhe punonjësja e shërbimeve **T.C. 94,680 lekë**, për **tejkallim normativave të karburantit** të mjetit tip “Benz” në përdorim të administratës me targa SR7319B, sipas rekordimit të fletudhëtimeve me sasinë e furnizuar dhe me normativat e miratuara, për vitin 2013 dhe për vitin 2014.

Brenda muajit Shtator 2016

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Konispol, në tenderin e zhvilluar me objekt “**Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol**”, të kryer në vitin 2014, me fond limit 33.442.763 lekë, procedurë prokurimit – e hapur, marrin pjesë 9 OE dhe s`kualifikuar 8 OE, fitues “M...” shpk, me vlerë fituese 32.371.343 lekë pa tvsh dhe diferencë nga fondi limit 1,071,000 lekë pa tvsh, rezultoi se:

-në zhvillimin e procedurës janë s`kualifikuar 4 OE me vlerë më të ulët dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues i pesti në radhë OE “M...”, i cili nuk justifikon çmimin e paraqitur për zërin shpim pilotash (të paraqitur 2,500 lekë/ml nga 51,000 lekë që e ka manuali i analizave teknike të çmimeve të ndërtimit),

-në kontratën e ngjashme e ka të paargumentuar çmimin për këtë zë pune. OE me vlerë më të ulët është s`kualifikuar nga gara se nuk e ka siç duhet makinerinë për çmimin me sondë (por që çmimin për këtë zë pune e ka 40.000 lekë/ml). KVO duhej ta s`kualifikonte këtë OE, të anulonte tenderin, pasi nuk mbetej asnjë ofertë e vlefshme në garë. KVO ka mbajtur qëndrim me dy standarde duke shkaktuar efekt ekonomik negativ me pasojë **dëmin ekonomik prej 9,245,413 lekë**. Sikurse ka rezultuar nga auditimi i zbatimit të kontratës ky zë pune nuk ka qenë i nevojshëm, është hequr dhe nuk është kryer.

Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **9,245,413 lekë**, që përbëhet nga vlerësimi i gabuar i ofertës ekonomike të shpallur fitues në tenderin me objekt “**Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol**”, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përkatësisht: **T.C. 3,081,804 lekë, Sh.Sh. 3,081,804 lekë dhe S.B. 3,081,804 lekë**.

Brenda vitit 2016

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rikonstruksion Qendra e Qytetit Konispol**”, Bashkia Konispol, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan:

-diferenca në volume pune të pakryera për **1,341,882 lekë pa t.v.sh dëm ekonomik**.

-dëme të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve për **6,603,333 lekë**. Përllogaritja: $Dëmi\ ditë = 8,092,836 \times 4/1000 = 32,369.3\ lekë/ditë$. Është tejkalluar afati i përfundimit të punimeve nga data 20.05.2015 deri më datën 10.10.2015, respektivisht gjithsej 204 ditë. Për 204 ditë $\times 32,369.3\ lekë/ditë = 6,603,333\ lekë$, për të cilën ngarkohet Operatori Fitues “M...” sh.p.k.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol dhe operatorit si sipërmarrës të punimeve “M...” sh.p.k, neni 4 dhe neni 6 pika 1, neni 34 dhe 34.1: “Dëmet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”

ku parashikohet se: Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **7,918,215 lekë** pa t.v.sh, nga të cilat:

- **Vlera 1,341,882 lekë** pa t.v.sh për punime të pakryera në fakt;

- **Vlera 6,603,333 lekë** dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve;

nga operatori ekonomik “M...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 514 prot., datë 30.06.2014 me objekt: **“Rikonstruksion Qendra e Qytetit Konispol”**, Bashkia Konispol, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera dhe dëme për vonesa në zbatim të kontratës .

Brenda muajit Gusht 2016

8. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Konispol është shpenzuar për shumën **60,000 lekë dëm ekonomik**, për subjektin fizik avokate A.H. “Për përfaqësim ligjor” pa dokumentuar dhe argumentuar se çfarë çështjeje ligjore ka përfaqësuar në gjyq për llogari të Bashkisë Konispol, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 36 dhe me VKM nr. 1”Për rregullat e prokurimit publik”.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **60,000 lekë** nga M.A. dhe S.B. me nga **30,000 lekë secili**.

Brenda muajit Gusht 2016

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e zëvendësimit, 11.3.2008 deri në 8.6.2008, është lidhur kontrata nr.prot;120/1, datë 20.3.2008, midis F.B. dhe ish-titullarit të Bashkisë Konispol P.M. Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me Ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000”Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” Neni 32”Detyrat dhe kompetencat e këshillit komunal ose bashkiak” germa “ç”, pasi nuk mund të zëvendësohen punonjësit që janë në organikën e miratuar nga Këshilli, kur janë me raport të përkohshëm mjeksor. Si pasojë, **Fatbardha Beqiri ka përfituar padrejtësisht shumën 72,708 lekë dëm ekonomik**”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e shumën **72,708 lekë** nga F.B. për **pagë të dubluar**.

Brenda muajit Qershor 2016

II. Për Njësinë Administrative Markat paraqet një dëm ekonomik në vlerën 74,136,802 lekë.

10. Gjetje nga auditimi: Në Njësinë Administrative Markat, në ish Komunën Markat, në tenderin e zhvilluar me objekt: **“Rruga Janjar-Ninat- Markat”**, të zhvilluar në vitin 2012, me fond limit 49.999.100 lekë, procedurë prokurimi – e hapur, marrin pjesë 6 OE dhe s’kualifikuar 4, fitues “N...” shpk, me vlerë 49.356.195 lekë pa tvsh, me diferencë nga fondi limit 62.905 lekë, rezultoi se: është s’kualifikuar me të padrejtë OE “S...” shpk, me vlerë më të ulët të ofertuar duke shkaktuar **efekt ekonomik financiar negativ me pasojë dëmin ekonomik** prej **7,432,624 lekë**, (Oferta e “S...” shpk

41.923.571 lekë – Oferta e “N...” shpk 49.356.195 lekë), në papajtueshmëri me Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, të VKM nr. 1, datë 20.01.2007. “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa “gj”, si dhe shtojca 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 5 të DST, duke mos vërtetuar në rrugë shkresore për marrjen e informacionit zyrtar mbi gjendjen e makinerive e mjeteve në dispozicion edhe në një kontratë që pretendon KVO se ky OE ka me MBU.

Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **7,432,624 lekë**, që përbëhet nga vlerësimi i gabuar i ofertës ekonomike të shpallur fitues në tenderin me objekt: “**Rruga Janjar-Ninat- Markat**”, nga KVO, përkatësisht **A.S. 1,858,156 lekë, E.R. 1,858,156 lekë, E.M. 1,858,156 lekë dhe ish Titullari i Autoritetit Kontraktor I.M.1,858,156 lekë.**

Brenda vitit 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rruga Janjar-Ninat-Markat**”, ish Komuna Markat, Konispol, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan:

- diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **15,319,200 lekë pa t.v.sh dem ekonomik,**

- dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve në vlerën **43,036,350 lekë.** Përllogaritje: $Dëmi\ ditë = 20,493,504 \times 2/1000 = 40,987\ lekë/ditë$. Është tejkaluar afati i përfundimit të punimeve nga data 12.05.2013 deri më datën 29.03.2016 kur mbahet është mbyllur auditimi, respektivisht gjithsej 1,050 ditë. Për 1,050 ditë $\times 40,987\ lekë/ditë = 43,036,350\ lekë$, për të cilën duhet të ngarkohet Operatori Fitues “N...” sh.p.k.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Markat, Konispol dhe operatorit ekonomik “N...” sh.p.k, neni 4 dhe neni 6 pika 1, neni 34 dhe 34.1: “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve” ku parashikohet se: Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **58,355,550 lekë pa t.v.sh** nga **subjekti “N...” sh.p.k.**, nga të cilat:

- **vlera 15,319,200 lekë** pa t.v.sh **për punime të pakryera në fakt;**

- **vlera 43,036,350 lekë dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin jo të plotë të punimeve;**

Nga operatori ekonomik “N...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 71, datë 12.09.2012 me objekt: “**Rruga Janjar-Ninat-Markat**”, ish Komuna Markat, Konispol, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit

të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera dhe dëme për vonesa në zbatim të kontratës.

Brenda vitit 2016

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i mbledhjeve të Këshillit Komunës Markat, rezultuan se disa nga këshilltarët janë paguar pa qenë prezent në mbledhje, çka ka krijuar vlerën **181,500 lekë dëm ekonomik, pagesa të paligjshme** për vitet 2013, 2014 dhe 2015, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **181,500 lekë** për **pagesa të paligjshme të 22 këshilltarëve** të ish-komunës Markat, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli, për vitin 2013, 2014 dhe 2015, përkatësisht: B.O. 27,500 lekë, Sh.S. 27,500 lekë, A.A. 5,500 lekë, Y.E. 5,500 lekë, B.M. 33,000 lekë, F.C. 16,500 lekë, A.M. 22,000 lekë, L.D. 16,500 lekë, P.A. 11,000 lekë, K.M. 5,500 lekë, H.M. 11,000 lekë.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: U konstatuan në 3 raste **paga të tepërta** për vlerën **145,735 lekë dëm ekonomik**, pasi janë paguar në kundërshtim me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586 datë 17.07.2013, përkatësisht: ish-kryetari i Komunës I.M. 103,150 lekë pasi ka përfituar padrejtësisht pagë mujore 58,000 lekë dhe 60,000 lekë nga 55,000 lekë dhe 56,100 lekë që duhej, pasi popullsia e kësaj njësie ka qenë nën 5000 banorë, ish-përgjegjësi financës I.B. 11,265 lekë dhe ish-punonjësi i komunës I.S. 31,320 lekë.

Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **145,735 lekë**, pasi janë paguar në kundërshtim me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586 datë 17.07.2013, përkatësisht: ish-kryetari i Komunës **I.M. 103,150 lekë**, ish-përgjegjësi financës **I.B. 11,265 lekë** dhe ish-punonjës i komunës **I.S. 31,320 lekë**.

Brenda muajit Korrik 2016

14. Gjetje nga auditimi: U konstatuan disa raste **paga të patërhequra dhe të paarkëtuara** të punonjësve me kontratë, këshilltarëve dhe kryetarëve të Fshatit për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2012 në vlerën **195,500 lekë dëm ekonomik**, sipas borderove (listpagesave) ku mungojnë nënshkrimet e marrësve të shoqëruara me mandatpagesat nr.1, nr. 2 dhe nr. 3 datë 23.01.2013. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **195,500 lekë**, paga të patërhequra dhe të paarkëtuara të punonjësve me kontratë, këshilltarëve dhe kryetarëve të Fshatit për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2012, sipas borderove ku mungojnë nënshkrimet e marrësve të shoqëruara me mandatpagesat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 datë 23.01.2013, përkatësisht: M.M. 13,500 lekë, O.H. 13,500 lekë, N.D. 13,500 lekë, K.M. 13,500 lekë, A.M. 13,500 lekë, L.D. 24,000 lekë, A.S. 24,000 lekë, D.H. 24,000 lekë, R.R. 24,000 lekë, S.D. 16,000 lekë, F.E. 16,000 lekë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Me veprimet e bankës, u konstatua vlera **550,661 lekë dëm ekonomik, shpenzime të pa justifikuara** me dokumente, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 2, datë 28.3.2013 “*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në*

njësitë e sektorit publik”, me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”, konkretisht:

- vlera 330,661 lekë, për riparimin e zhbllokimin e rrugës nga reshjet 29-30-31 janar 2015, pasi mungon fatura, preventivi, situacioni, vendimi i Këshillit Komunës, procesverbali i komisionit shërbimeve të vogla, fotografimet para dhe pas meremetimit të objektit, akt marrja në dorëzim etj, sipas urdhër shpenzimit nr. 16, datë 9.02.2015, nr. 17 datë 10.02.2015, faturës nr. 1, 2,3 datë 6.2.2015.

-vlera 220,000 lekë, për pjese këmbimi dhe mirëmbajtje automjeti, pasi praktika e pagesës nuk shoqërohet me asnjë dokument justifikues, përkatësisht mungon fatura, preventivi, situacioni, procesverbalet e komisionit shërbimeve të vogla dhe specialistit fushës etj, sipas urdhër shpenzimit nr. 41, datë 10.04.2015.

Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **550,661 lekë (330,661+220,000)**, përkatësisht ish-Kryetari i Komunës **I.M. 275,330 lekë dhe I.B. 275,330 lekë**, shpenzime të pa justifikuara me dokumente në 2 raste, pasi mungon fatura, preventivi, situacioni, vendimi i Këshillit Komunës, procesverbali i komisionit shërbimeve të vogla, fotografimet para dhe pas meremetimit të objektit, akt marrja në dorëzim etj, sipas urdhër shpenzimeve nr. 16, datë 9.02.2015, nr. 17 datë 10.02.2015, nr. 41, datë 10.04.2015, faturës nr. 1, 2,3 datë 6.2.2015.

Brenda Muajit Shtator 2016

16. Gjetje nga auditimi: Me veprimet e bankës u konstatuan **3 raste** përfitim **dieta të tepërta** për vitin 2013, 2014, 6-mujori 2015, në vlerën **102,000 lekë dëm ekonomik**, pasi janë kryer pagesat për shpenzimet e hotelit pa faturën tatimore dhe pa kuponët tatimor elektronik, veprim në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” pika III/3 nënpika 3.2.

Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **102,000 lekë** përfitim **dieta të tepërta** për vitin 2013, 2014, 6-mujori 2015, pasi janë kryer pagesat për shpenzimet e hotelit pa faturën tatimore dhe pa kuponët tatimor elektronik, konkretisht:

-vlera 69,000 lekë, nga I.M. sipas urdhër shpenzimit nr. 4, datë 17.11.2014 për datat 3, 4, 5, 25, 26, 27 nëntor 2014 dhe 3, 4, 22, 23 dhjetor 2014, sipas urdhër shpenzimit nr. 31, datë 9.3.2015 (dieta janar-shkurt) për datat 12,13, 14, 21, 22, 27,28,29 janar 2015 dhe 4, 5, 17, 18, 19 shkurt 2015.

-vlera 24,000 lekë, nga I.B. sipas urdhër shpenzimit nr. 4, datë 17.11.2014 për datat 10 e 11 dhjetor 2014, sipas urdhër shpenzimit nr. 31, datë 9.3.2015 (dieta janar-shkurt) për datat 19,20, 21, 23, 24, 25 janar 2015.

-vlera 9,000 lekë, nga A.I. sipas urdhër shpenzimit nr. 31, datë 9.3.2015 (dieta janar-shkurt) për datat 27, 28, 29 janar 2015.

Brenda muajit Korrik 2016

17. Gjetje nga auditimi: U konstatua se **nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH**, sipas shkresës nr. 380/6, datë 6.2.2012, për ish-Komunën Markat sot Njësia Administrative Markat e Bashkisë Konispol, për 4 masa dëmshpërblimi në shumën **774,498 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht: subjekti “A...L” në vlerën 289,150 lekë, subjekti “A...” në vlerën 337,600 lekë, subjekti “E...&C...” shpk në vlerën 97,288 lekë dhe subjekti “E...” shpk në vlerën 50,000 lekë.

Rekomandimi: Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të mëparshme nga Bashkia Konispol, duke kontabilizuar dhe arkëtuar vlerën **774,498 lekë**, përkatësisht: subjekti “A...L” shpk në vlerën **289,150 lekë**, subjekti “A...” shpk në vlerën **337,600 lekë**,

subjekti “E...&C...” shpk në vlerën 97,288 lekë dhe subjekti “E...” shpk në vlerën 50,000 lekë, sipas shkresës të KLSH nr. 380/6, datë 6.2.2012, për ish-Komunën Markat.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Markat e Bashkisë Konispol është audituar më parë nga **Prefektura Vlorë**, ku për problemet e konstatuara janë rekomanduar disa masa zhdëmtimi të cilat nuk janë zbatuar. KLSH ka audituar këtë njësi dhe për efekt mos dublimit të shkeljeve, problemet janë shkruar në një material të vetëm, ku ka rezultuar:

-vlera 796,538 lekë për subjektin “T...” shpk, për punë të pakryer në 2 objekte kontraktore të komunës Markat, përkatësisht: 21,710 leke për objektin “Ambulance fshati Janjar” dhe 774,828 lekë për objektin “shkolla 9-vjeçare fshati Janjar”, detyrë e pa realizuar, pasi subjekti nuk ka arkëtuar vlerën, megjithatë njoftimet e dërguara nga ana e bashkisë, sipas shkresës nr. 139, datë 27.01.2016 dhe nr. 392, datë 10.3.2016.

Rekomandimi: Rikërkojmë Bashkisë Konispol, zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të Auditit të Prefekturës Vlorë, për ish-Komunën Markat, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës 796,538 lekë për subjektin “T...”shpk, për punë të pakryer në 2 objekte kontraktore të komunës Markat, përkatësisht 21,710 lekë për objektin “Ambulancë fshati Janjar” dhe 774,828 lekë për objektin “shkolla 9-vjeçare fshati Janjar”.

Brenda muajit Korrik 2016

19. Gjetje nga auditimi: Në njësinë Administrative Markat (ish Komuna Markat) për vitet 2013, 2014, në 23 raste nga auditimi i veprimeve të bankës u konstatuan shkelje ligjore, me pasojë 5,302,780 lekë dëm ekonomik, në shpenzimet për investime dhe blerje të vogla, pa dokumente justifikuese në urdhër shpenzimet, pa procedura prokurimi etj, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rekomandimi: Bashkia Konispol (Njësia Administrative Markat) të marrë masa për arkëtimin e shumën 5,302,780 lekë nga I.M. ish-Kryetar i Komunës Markat 2,651,390 lekë dhe I.B. ish-përgjegjës i financës 2,651,390 lekë për kryerjen e shpenzimeve të paligjshme dhe pa dokumentacion justifikues.

Brenda vitit 2016

C. MASA ADMINISTRATIVE

I. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Konispol.

Nga Bashkia Konispol të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor , të vendosë masë administrative me gjobë, për:

1. vlerën 200,000 lekë për ing: M.Ç. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “**Rikonstruksion Qendra e Qytetit Konispol**”, Bashkia Konispol, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 7,945,215 lekë pa tvsh, nga të cilat vlera 1,341,882 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 6,603,333 lekë si pasojë e dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve. Veprime këto në kundërshtim me

nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

2. vlerën 100,000 lekë për ing: **Dh.L.** nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me “**Rikonstruksion Qendra e Qytetit Konispol**”, Bashkia Konispol, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën **7,945,215 lekë pa tvsh**, nga të cilat vlera **1,341,882 lekë pa TVSH** për punime të pakryera në fakt dhe vlera **6,603,333 lekë** si pasojë e dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve. Veprime këto në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 3.

II. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban (Komisioni i Licencave)

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullores për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë Komisionit të Licencave**, pranë Ministrisë Zhvillim Urban, heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim (**heqjen e Licencës profesionale**), për një afat nga **2-3 vjet**, si më poshtë:

1.V.G. (nën cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës “PALMA CONSTRUCTION” shpk (firma **mbikëqyrëse** me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve);

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e mangësive të theksuara gjatë zbatimit të kontratës për investime në objektin:

- “**Rruga Janjar-Ninat-Markat**”, ish Komuna Markat, Konispol, në vlerën **58,355,550 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik**, nga të cilat vlera **15,319,200 lekë pa TVSH** për punime të pakryera në fakt dhe vlera **43,036,350 lekë** si pasojë e dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve. Më konkretisht si më poshtë:

“Rruga Janjar-Ninat-Markat”, ish Komuna Markat, Konispol.

Për ndjekjen e zbatimit të kontratës është caktuar, subjekti “P...” Shpk me licencë për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi nr. MK. 088/13 datë 03.02.2015, me nipt K6660700U, përfaqësuar nga ing. V.G. me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me nr. ext prot, datë 12.09.2012, me vlerë të përcaktuar 395,000 lekë pa TVSH ose 474,000 lekë me TVSH. Afati i kryerjes së shërbimit për mbikëqyrjen e punimeve është afati i zbatimit të kontratës së sipërmarrjes.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **58,355,550 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik**, nga të cilat vlera **15,319,200 lekë pa TVSH** për punime të pakryera në fakt dhe vlera **43,036,350 lekë** si pasojë e dëmeve të

likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve, mangësi në dokumentacion si dhe problematikat si më poshtë:

I. Mangësi në dokumentacion:

Konstatohet se në dokumentacionin teknik mungojnë:

1. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit;
2. Mungon plan-organizimi i punimeve të ndërtimit;
3. Mungon libri i kantierit;
4. Grafiku i punimeve;
5. Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;
6. Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
7. Mungojnë aktet e inspektimeve të kryera gjatë zbatimit të punimeve;
8. Deklarata teknike e sipërmarrësit të punimeve;
9. Deklarata teknike e mbikëqyrësit të punimeve;
10. Kontrata me kolaudatorin e punimeve;
11. Mungon libreza e masave;
12. Ditari i objektit;
13. Fotot gjatë punimeve;

II. Mangësitë në zbatimin e punimeve:

Konkretisht nga auditimi i kryer rezultoi se *janë përfituar nga sipërmarrësi “N...” sh.p.k më tepër në vlerë, në vlerën 58,355,550 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, nga të cilat vlera 15,319,200 lekë pa TVSH për punime të pakryera në fakt dhe vlera 43,036,350 lekë si pasojë e dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve.*

- Vlera **15,319,200 lekë pa TVSH** si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave. Këto veprime janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve, neni 23, pika 23.2 në kontratën me për punë publike nr. 71 prot., datë 12.09.2012 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish Komuna Markat përfaqësuar nga kryetari I.M. dhe operatorit ekonomik “N...” Shpk të përfaqësuar nga administratori i shoqërisë SH.N.

- Vlera **43,036,350 lekë** si pasojë e dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve. Nga auditimi i dokumentacioni teknik, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve ka rezultuar se sipërmarrësi i punimeve, *shoqëria e ndërtimit “N...” shpk*, nuk ka zbatuar afatet kohore të vendosura në kontratën për punë publike nr. 71 prot., datë 12.09.2012 dhe ka tejkaluar atë për 1,050 ditë kalendarike ose 2 vjet e 11 muaj pa paraqitur argumente duke mos i përfunduar punimet e kontraktuara brenda afatit ligjor të vendosur në kontratë. Punimet duhej të kishin përfunduar në datën 12.05.2013 sipas kontratës për punë publike nr. 71 prot., datë 12.09.2012, por deri në datën 24.03.2016 kur është përfunduar auditimi, punimet rezultojnë akoma të papërfunduara duke tejkaluar me 1,050 ditë këtë afat.

Nga mbikëqyrësi i punimeve, V.G. është vepruar në kundërshtim me:

- ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7,

- udhëzimin e KM nr.3, datë 15.02.2001 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3

- me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor ish-Komuna Markat, Konispol ku përcaktohen Detyrimet e mbikëqyrësit.

III. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

A. Mbështetur në nenin 59 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik “ i ndryshuar, **propozojmë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhënien e masave administrative, për KVO dhe njësinë e prokurimit**, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për 3 anëtarët e njësisë së prokurimit:

1. A.B. Drejtor i urbanistikës, në cilësinë përgjegjësit njësisë prokurimit,

2. O.Gj. inspektor i INUV, në cilësinë anëtarit njësisë prokurimit,

3. K.K. N/kryetare e bashkisë, në cilësinë anëtarit njësisë prokurimit,
për shkeljet e përbashkëta si më poshtë:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik i hapur, në objektin “**Rikonstruksion i sheshit qendror të qytetit**”, të vitit 2015, rezultoi se:

*-Njësia e prokurimit disa kriteret të veçanta kualifikimi i ka formuluar në mënyrë evazive dhe jo të qartë, të cilat nuk ndikojnë në qëllimin e realizimit të procedurës së prokurimit, çka ka ndikuar tek KVO në skualifikimin e operatorëve ekonomik, duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik, duke mos kursyer vlerën **13,019,178 lekë** (43,764,730-30,745,552) **mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike**, konkretisht:*

a. numri i fuqisë punëtore mbi 60 punonjës nuk justifikohet për periudhën 4 muajore të kryerjes të këtij objekti , pasi mund të kryhet me më pak punonjës meqë janë prezentë dhe makineritë e punës, duke krijuar një raport të drejtë me afatin kohor të mbylljes së objektit.

b. stafi drejtues në mënyrë të pa argumentuar kërkohet në numër të madh prej 6 inxhinierë, për “*Rikonstruksion i sheshit qendror të qytetit* ” konkretisht ing: ndërtimit, elektrik, topograf, hidroteknik dhe mjedisi, ku një pjesë e tyre nuk janë të nevojshëm ose kompensojnë njeri tjetrin, për volumin e punës që kanë, ndërsa tek tenderi riparim i objektit “*Emergjencë Ura e Shalës*” nuk kërkohet asnjë inxhinier ku inxhinieri hidroteknik është i domosdoshëm për emergjencat nga përmblytjet për ura për rastin në fjalë. Madje pa argumentim kërkohet për inxhinierët CV dhe librezat e punës të cilat nuk janë objekt për procedurën e prokurimit, por janë objekt për punësim dhe pension, ndërsa është i drejtë kriteri për kontratën dhe diplomën.

c. drejtuesit teknik kërkohen në numër të madh dhe me përvojë 10 vjeçare, por nuk argumentohen arsyet e vendosjes së këtij kufiri, madje kërkohet përveç diplomës dhe kontratës punës edhe CV dhe librezat e punës. Kështu kërkohet punonjës teknik (*zanatçin*), konkretisht: 2 teknik ndërtimi, 2 elektrikist, 1 manovrator, 2 saldator, të certifikuar nga IQT, ndërsa tek tenderi i emergjencës nuk kërkohet asnjë prej tyre.

d. për pemët dekorative përveç specifikimeve teknike nuk argumentohet pse duhet kontrata paraprake e furnizimit. Tek specifikimet teknike kërkohet lartësia e pemëve 15-20 metër, çka është i pamundur transporti i tyre nga Lezha-Konispol 360 (km) për lartësinë që kanë.

e. Në kriteret për kualifikim kërkohen kategori të cilat nuk kane lidhje me objektin që prokurohet, konkretisht: kategoria NP-5-A, ka te beje ka te beje me *punime nëntokësore, ura dhe vepra arti* dhe referuar preventivit të publikuar rezulton se nuk ka zëra të tilla dhe kategoria NS-8, ka te beje me *punime parafabrikat betoni arme, struktura metalike e druri*.

Kriteret e veçanta të kualifikimit të trajtuara nga ana jonë, për objektin “*Rikonstrukcion sheshit qendror qytetit*”, kanë qenë objekt dhe i ankesës datë 01.12.2015 të operatorit ekonomik “K...” shpk, ankesë që nuk është marrë parasysh nga njësia e prokurimit, sipas përgjigjes saj datë 3.12.2015.

Për 3 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. E.D. përgjegjës financës i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Kryetarit të KVO,

5. T.Ç. teknike e mesme në sektorin e shërbimeve të Bashkisë Konispol, në cilësinë e anëtares të KVO,

6. Sh.Sh. inspektor kullotash i Bashkisë Konispol, në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljen e përbashkët si më poshtë:

-KVO në procedurën e prokurimit në objektin “***Rikonstrukcion i sheshit qendror të qytetit 2015***”, ka kualifikuar dhe shpallur fituese për vlerën 43,764,730 leke pa tvsh “G...” shpk, duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik, pasi subjekti fitues paraqet vlerën me te larte ose me nje difference **13,019,178 lekë mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike**, krahasuar me BOE “J...” & “Sh...” (43,764,730-30,745,552). KVO për mangësi të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, mund ti jepte prioritet operatorit me ofertë me leverdi ekonomike. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe me sigurimin e trajtimit të barabartë të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

B. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit. Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në tenderat e Bashkisë Konispol, duke vendosur **marrjen e masave administrative (dënim me qjobë)** në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor **(për marrjen e masave disiplinore)**, ndaj **6 punonjësve të Bashkisë Konispol**, si më poshtë:

1.A.B. përgjegjës Urbanistikës i bashkisë Konispol, në cilësinë e antarit të NJHDT,

2.K.K. n/kryetare e bashkisë Konispol, në cilësinë e antarit të NJHDT,

3.O.Gj. inspektor i INUV i bashkisë Konispol, në cilësinë e antarit të NJHDT,

4.T.C. përgjegjëse e shërbimeve e bashkisë Konispol, në cilësinë e kryetares të KVO,

5.Sh.Sh. inspektor kullotash i bashkisë Konispol, në cilësinë e antarit të KVO,

6.S.B. llogaritar dhe ish-përgjegjës i financës i bashkisë Konispol, në cilësinë e antarit të KVO.

për shkëlqen e përbashkët si më poshtë:

Për tenderat e vitit 2014

Në tenderin e zhvilluar në Bashkinë Konispol, në vitin 2014, me objekt **“Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol”**, me fond limit 33,442,763 lekë, me procedurë prokurimi tender i hapur, të fituar nga OE “M...” shpk, me vlerë 32,371,343 lekë pa tvsh rezultoi se:

- Në kërkesat e veçanta për kualifikim, në kapacitetin teknik, në plotësimin e punimeve të ngjashme, është kërkuar që “Në zërat e punimeve të ngjashme të ketë patjetër një zë të realizuar për ndërtim pilotash”, kërkesë e tejkaluar mbi VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III.

- Në lidhje me kategoritë e licensës për kategoritë NP4 dhe NP 5 është kërkuar niveli B i kategorisë, në një kohë që duhet të ishte niveli A, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- Ankimimet e paraqitur në AK, janë trajtuar në kundërshtim me Kreun IX, “Shqyrtimi i ofertave”, të VKM nr.1, datë 10.101.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk ka asnjë urdhër të Titullarit të AK .

- Në zhvillimin e procedurës është kualifikuar në vend të parë OE me vlerë më të lartë “M...” shpk në kushtet kur për zërin ndërtim pilotash (I cili sipas kërkesave të veçanta për kualifikim është i domosdoshëm), ka **ofertuar çmimin 2.500 lekë nga 51.826 lekë** që është çmimi me manualin e analizave teknike ose 4.8 % e çmimit të analizës sipas manualit, **çmim shumë anomalisht i ulët dhe ne papajtueshmëri me VKM nr. 514,** date 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, me ndryshime, e cila përcakton se të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr. 2, date 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu përcakton se metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit të çdo prokurimi, me fonde publike, në fushën e projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe e kontabilitetit teknik për çdo punim ndërtimi, si dhe detyron të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve, të llogaritura, me programin e miratuar. Ky OE ka paraqitur kontratë të ngjashme për ndërtim pallati në të cilin zëri cpim me sondë me përshkrimin “shpim me sondë dhe betonim të pilotave për mbështetjen e themeleve të objektit” njësinë matëse e ka m³, në një kohë që në manualin e analizave të çmimeve të ndërtimit zëri shpim me sondë është në ml, është vetëm për shpim dhe zëri betonim është më vete, për rrjedhojë kjo kontratë e ngjashme për këtë lloj punimi nuk jep informacion. Volumi i punimeve të kapitullit “Punime për struktura speciale” ku përfshihet edhe ky zë pune është hequr nga zbatimi i punimeve, nga ku rezulton se kërkesa ka qenë e paargumentuar. Për rrjedhojë rezulton vlera **9,245,413 lekë dëm ekonomik.**

C. Bazuar në nenin 13, pika 3/ç, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, përfshirjen e OE “E...”shpk dhe “I...” shpk për deklarime të rreme, për arsyt sa vijon:

a- Në tenderin e zhvilluar në Bashkinë Konispol, me objekt **“Rikonstruksion “Rruga Rrahut, Konispol”, të zhvilluar në vitin 2014**, me fond limit 2.569.000 lekë, fituar nga OE “N...” shpk, me vlerë 1.850.700 lekë pa tvsh dhe në tenderin e zhvilluar në ish Komunën Markat (sot Njësia Administrative Markat e Bashkisë Konispol), me objekt **“Rruga Janjar-Ninat-Markat”**, të zhvilluar në vitin 2012, me fond limit 49.999.100 lekë, të fituar nga OE “N...” shpk, me vlerë 49.356.195 lekë pa tvsh, në të cilat ka marrë pjesë në procedura OE **“E...”shpk**, u konstatua se:

Operatori ekonomik “E...” shpk ka paraqitur Ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, dhe ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, në të cilën emri i subjektit është “E...”. Nga auditimi i mëtejshëm i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se ky OE ka paraqitur Licence të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit me nr.NZ 2944/16, për shoqërinë me emërtimin “E...”. Afati i kësaj licence është deri më datë 05.05.2043. Ky OE në të gjithë dokumentacionin e paraqitur me përfshirje të licencës profesionale ka emërtimin e shoqërisë “E...” shpk. Ky OE nuk ka ndryshuar emërtimin në licencën në fjalë, duke paraqitur një licencë të rreme.

b- Në tenderin e zhvilluar në ish Komunën Markat (sot Njësia Administrative Markat e Bashkisë Konispol), me objekt **“Ndërtimi i ujësjellësit Markat-Ninat dhe rrjeti i brendshëm”**, të zhvilluar në vitin 2014, me fond limit 21.104.374 lekë, me fitues “A...” shpk, me vlerë 20.400.549 lekë pa tvsh, rezultoi se OE **“I...”** shpk ka hedhur në sistemin e app.gov.al, dokumentacionin e OE “A...” shpk, të njëjtë nga forma dhe përmbajtja, duke paraqitur dokumentacion të rreme.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58 germa ç, c, b, a **“llojet e masave disiplinore”** të ligjit nr. 152/2013 **“Për nëpunësin civil”**, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, **“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”**, kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 **“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”**, **kërkojmë kryetarit të Bashkisë Konispol**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të caktuar më poshtë dhe marrjen e masës disiplinore, sa vijon:

I. “Vërejtje” deri në “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë “Vërejtje” deri në “Ndërpërje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

1. K.K. Juriste, aktualisht N/Kryetare e Bashkisë Konispol për shkeljet e mëposhtme:
-për mos marrjen e masave për regjistrimin e pasurive të llojit pyll dhe kullotë në sipërfaqen 2608 ha, pronë e Bashkisë Konispol pranë ZVRPP Sarandë, transferuar me VKM nr.113,datë 13.2.2013”Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkia Konispol, Qarku Vlorë” në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 **“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”**, pika 20.

-për mos administrim të certifikatave të pasurive të lëshuara nga ZVRPP Sarandë për sipërfaqen 395,72 ha kullotë dhe pyll regjistruar si pronë e Bashkisë Konispol, në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 *“Për regjistrimin pasurive pa luajtshme”*, neni 32.

-për mos hartimin e programit për regjistrimin e vlerave të pronave në kontabilitet në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”*, pikës 22.

-për mos ndjekjen e kontratave të lidhura me fermerët për tokat me qira, për pagesën e qirasë sipas kushteve të kontratës në kundërshtim me ligjin 7850 datë 29.07.1994 *“Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë”* neni 420.

- për mos ndjekjen e afateve të kontratës së lidhur me “A...” sha, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, pika 5, gërma ”a”.

-për shkelje në procedurën e prokurimit publik në objektin *“Rikonstruksion i sheshit qendror të qytetit”*, të vitit 2015, pasi njësia e prokurimit disa kriterë të veçanta kualifikimi i ka formuluar në mënyrë evazive dhe jo të qartë, të cilat nuk ndikojnë në qëllimin e realizimit të procedurës së prokurimit, çka ka ndikuar tek KVO në skualifikimin e operatorëve ekonomik, duke mos kursyer vlerën 13,019,178 lekë (43,764,730-30,745,552) mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, konkretisht: numri i fuqisë punëtore mbi 60 punonjës, stafi drejtues prej 6 inxhinierë, drejtuesit teknik me përvojë 10 vjeçare, librezë e punës, për pemët dekorative specifikimet teknike kërkohet lartësia e pemëve 15-20 metër, kategoria NP-5-A, ka të beje ka të beje me punime nëntokësore, ura dhe vepra arti dhe referuar preventivit të publikuar rezulton se nuk ka zëra të tilla dhe kategoria NS-8, ka të beje me punime parafabrikat betoni arme, struktura metalike e druri. Këto Kriterë të veçanta kanë qenë objekt dhe i ankesës datë 01.12.2015 të operatorit ekonomik “K...” shpk, ankesë që nuk është marrë parasysh nga njësia e prokurimit, sipas përgjigjes saj datë 3.12.2015.

2. M.S. Përgjegjëse e ZMMT, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos mbajtjen e evidencave të plota, të rakorduar me proces verbale dhe akt-verifikime vjetore mbi gjendjen faktike, si Bashki, për zërat kadastrave, tokë arë, pemishte, vreshta, ullishte, për sipërfaqet e pyjeve, kullotave, për trojet, për hapësirat e tjera si lumenjtë, rezervuarët, përrenjtë, kanalet kullues e vaditës, rrugët e fshatrave, ato nacionale, sipërfaqet si troje të zëna për varreza, sipërfaqet shkëmbore etj në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.2.2011, kreu IV *“Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”*.

-për mos saktësimin me evidenca pronat shtet dhe ato private, të shoqëruar këto me hartat përkatëse nga Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave (ZMMT) në bashkëpunim me AKKP, Zyrën e AMT në Këshillin e Qarkut dhe ZRPP në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.2.2011, kreu IV *“Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”*.

-për mos evidentimin e sipërfaqeve tokës bujqësore dhe zërave të tjerë kadastrave të cilat janë dëmtuar nga faktorët natyrorë dhe mos kryerjen ndryshimet në Regjistrat themeltarë në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.2.2011, kreu IV *“Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”*.

-për mos mbajtjen e proces verbaleve për transferimin e zërave kadastrave tokë bujqësore në troje, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin edhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar dhe VKM nr. 121, datë 17.2.2011, kreu IV “Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”.

-për mos evidentimin e ndryshimeve të zërave kadastralë me një regjistër të posaçëm, të shoqëruar me hartat përkatëse dhe mos mbajtja e dokumenteve në Arkiv, në kundërshtim me VKM nr. 121, datë 17.2.2011, kreu IV “Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”.

-për mos mbajtjen e evidencave mbi aktet e marrjes së tokës bujqësore në pronësi nga përdoruesit faktik në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore”.

3. U.S. përgjegjës i zyrës së taksave vendore, Bashkia Konispol, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos dërgim bankave të nivelit të dytë të listës së subjekteve debitore, në zbatim të nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008;

-për mos vendosjen e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Transportit për mjetet, apo ZVRPP Sarandë ndaj subjekteve debitorë, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008;

-për mos zbatim të procedurave të parashikuara në Kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara, i ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore” me ndryshime dhe pikat 3 dhe 5, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Financave dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003; pikat 4. nënpikat 4.1.4.3, pikat 5, 6, 8 dhe 9 e udhëzimit të MF nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”; nenin 17 dhe neni 34, shkronja “a”, pika 3, pasi nuk është proceduar në mbylljen e subjekteve debitor të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat e tarifat vendore;

-për mos aplikim të sanksioneve ndaj subjekteve debitore për vonesat në likuidim të detyrimeve (sipas periudhave), në zbatim të nenit 17, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XIV-Sanksionet, neni 114- Mospagimi në afat”.

-për mos realizimin e të ardhurave vendore dhe krijimin e diferencës 15 milion lekë mungesë të ardhurash për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

4. R.M. me detyrë arkëtare e Njesisë Administrative Markat, pasi nuk ka arsimin e duhur për pozicionin e punës që mbulon, është me arsim të mesëm të përgjithshëm.

II. Marrjen e masës disiplinore “Largim nga puna” dhe për ata me kontratë “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për këta punonjës:

1. Artur Beqiri, Drejtor i urbanistikës, në cilësinë anëtarit të njesisë prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

- për shkelje në procedurën e prokurimit publik në objektin “Rikonstruktion i sheshit qendror të qytetit”, të vitit 2015, pasi njësia e prokurimit disa kritere të veçanta

kualifikimi i ka formuluar në mënyrë evazive dhe jo të qartë, të cilat nuk ndikojnë në qëllimin e realizimit të procedurës së prokurimit, çka ka ndikuar tek KVO në skualifikimin e operatorëve ekonomik, duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik, duke mos kursyer vlerën 13,019,178 lekë (43,764,730-30,745,552) mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, konkretisht: numri i fuqisë punëtore mbi 60 punonjës, stafi drejtues prej 6 inxhinierë, drejtuesit teknik me përvojë 10 vjeçare, librezat e punës, për pemët dekorative specifikimet teknike kërkohet lartësia e pemëve 15-20 metër, kategoria NP-5-A, ka të beje ka të beje me punime nëntokësore, ura dhe vepra arti dhe referuar preventivit të publikuar rezulton se nuk ka zëra të tilla dhe kategoria NS-8, ka të beje me punime parafabrikat betoni arme, struktura metalike e druri. Këto

Kritere të veçanta kanë qenë objekt dhe i ankesës datë 01.12.2015 të operatorit ekonomik “K...” shpk, ankesë që nuk është marrë parasysh nga njësia e prokurimit, sipas përgjigjes saj datë 3.12.2015.

- për shkelje në procedurën e prokurimit publik me objekt “Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol”, pasi:

a. në kërkesat e veçanta për kualifikim, në kapacitetin teknik, në plotësimin e punimeve të ngjashme, është kërkuar që “Në zërat e punimeve të ngjashme të ketë patjetër një zë të realizuar për ndërtim pilotash”, kërkesë e tejkaluar mbi VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III.

b. në lidhje me kategoritë e licensës për kategoritë NP4 dhe NP 5 është kërkuar niveli B i kategorisë, në një kohë që duhet të ishte niveli A, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

c. Ankimimet e paraqitur në AK, janë trajtuar në kundërshtim me Kreun IX, “Shqyrtimi i ofertave”, të VKM nr.1, datë 10.101.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk ka asnjë urdhër të Titullarit të AK.

- për hartimin e dokumenteve standarde fiktive në tenderin “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Konispol, për vitin 2013, sipas procesverbalit të datës 14.3.2013, pasi rezulton se njësia e prokurimit në fakt kishte në përbërje dy antarë A.B. e O.Gj. dhe jo tre, siç është cilësuar në procesverbalin e njësisë së prokurimit.

2. E.D. përgjegjës financës i Bashkisë Konispol dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

- për shkelje në procedurën e prokurimit publik në objektin “Rikonstruksion i sheshit qendror të qytetit”, të vitit 2015, pasi njësia e prokurimit disa kritere të veçanta kualifikimi i ka formuluar në mënyrë evazive dhe jo të qartë, të cilat nuk ndikojnë në qëllimin e realizimit të procedurës së prokurimit, çka ka ndikuar tek KVO në skualifikimin e operatorëve ekonomik, duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik, duke mos kursyer vlerën 13,019,178 lekë (43,764,730-30,745,552) mos efektivitet në përdorimin e fondeve publike, konkretisht: numri i fuqisë punëtore mbi 60 punonjës, stafi drejtues prej 6 inxhinierë, drejtuesit teknik me përvojë 10 vjeçare, librezat e punës, për pemët dekorative specifikimet teknike kërkohet lartësia e pemëve 15-20 metër, kategoria NP-5-A, ka të beje ka të beje me punime nëntokësore, ura dhe vepra arti dhe referuar preventivit të publikuar rezulton se nuk ka zëra të tilla dhe kategoria NS-8, ka të beje me punime parafabrikat betoni arme, struktura metalike e druri. Këto

Kritere të veçanta kanë qenë objekt dhe i ankesës datë 01.12.2015 të operatorit ekonomik “K...” shpk, ankesë që nuk është marrë parasysh nga njësia e prokurimit, sipas përgjigjes saj datë 3.12.2015.

3. O.Gj. inspektor i INUV, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos përputhje të profesionit me vendin e punës, pasi është jashtë profesionit të kërkuar inxhinier ose teknik i mesëm ndërtimi, është me arsim të mesëm bujqësor, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” neni 11” si dhe për mos sistemimin, inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të INUV, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

- për shkelje në procedurën e prokurimit publik me objekt “Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol 2014”, pasi:

a. në kërkesat e veçanta për kualifikim, në kapacitetin teknik, në plotësimin e punimeve të ngjashme, është kërkuar që “Në zërat e punimeve të ngjashme të ketë patjetër një zë të realizuar për ndërtim pilotash”, kërkesë e tejkaluar mbi VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III.

b. në lidhje me kategoritë e licensës për kategoritë NP4 dhe NP 5 është kërkuar niveli B i kategorisë, në një kohë që duhet të ishte niveli A, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

c. Ankimimet e paraqitur në AK, janë trajtuar në kundërshtim me Kreun IX, “Shqyrtimi i ofertave”, të VKM nr.1, datë 10.101.2007, “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk ka asnjë urdhër të Titullarit të AK .

- për hartimin e dokumenteve standarde fiktive në tenderin “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Konispol, për vitin 2013, sipas procesverbalit të datës 14.3.2013, pasi rezulton se njësia e prokurimit në fakt kishte në përbërje dy antarë A.B. e O.Gj. dhe jo tre, siç është cilësuar në procesverbalin e njësisë së prokurimit.

4. T.C. përgjegjës i zyrës shërbimeve e bashkisë Konispol, në cilësinë e anëtarit të KVO,

5. Sh.Sh. inspektor kullotash i bashkisë Konispol, në cilësinë e anëtarit dhe kryetares të KVO,

për shkeljet e përbashkëta, si më poshtë:

- për kualifikimin e shpalljen fitues të operatorit “G...” shpk, në objektin “Rikonstrukcion i sheshit qendror të qytetit 2015”, për vlerën 43,764,730 leke pa tvsh duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik, pasi ky operator paraqet vlerën më të lartë ose me një diferencë 13,019,178 lekë mos efektivitet ne perdorimin e fondeve publike, krahasuar me BOE “J...” & “Sh...” (43,764,730-30,745,552).KVO në procedurën e prokurimit KVO për mangësi të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, mund të jepte prioritet operatorit me ofertë me leverdi ekonomike. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe me sigurimin e trajtimit të barabartë të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

-për kualifikimin e shpalljen fitues OE “M...” shpk, në tenderin e vitit 2014, me objekt “Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol”, me fond limit 33,442,763 lekë, me vlerë më të lartë në kushtet kur për zërin ndërtim pilotash (i cili sipas kërkesave të veçanta për kualifikim është i domosdoshëm), ka ofertuar çmimin 2.500 lekë nga 51.826 lekë që është çmimi me manualin e analizave teknike ose 4.8 % e çmimit të analizës sipas manualit, çmim shumë anomalisht i ulët dhe në papajtueshmëri me VKM nr. 514, date 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e

manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, çka ka shkaktuar vlerën 9,245,413 lekë dëm ekonomik.

-për shkelje në procedurat e blerjeve me vlera të vogla në 2 raste.

6. S.B. llogaritar dhe ish-përgjegjës i financës të bashkisë Konispol, në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

-për kualifikimin e shpalljen fitues OE “M...” shpk, në tenderin e vitit 2014, me objekt “Rikonstruksioni i qendrës së Qytetit, Konispol”, me fond limit 33,442,763 lekë, me vlerë më të lartë në kushtet kur për zërin ndërtim pilotash (i cili sipas kërkesave të veçanta për kualifikim është i domosdoshëm), ka ofertuar çmimin 2.500 lekë nga 51.826 lekë që është çmimi me manualet e analizave teknike ose 4.8 % e çmimit të analizës sipas manualit, çmim shumë anomalisht i ulët dhe ne papajtueshmëri me VKM nr. 514, date 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, çka ka shkaktuar vlerën 9,245,413 lekë dëm ekonomik.

III. Shënim: Për 7 punonjësit e mëposhtëm të cilën nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Konispol, nisur nga shkeljet e konstatuara **do të kërkonim masë disiplinore ndërprerje të marrëdhënieve të punës dhe largim nga shërbimi civil**, por meqenëse nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Konispol, kjo masë quhet e ezauruar, për:

1. M.A. ish-kryetar i bashkisë Konispol, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor,

2. I.M. ish-Kryetar i Komunës Markat, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor,

3. I.B. ish-përgjegjës i financës Komuna Markat, në cilësinë e hartuesit të dokumenteve të tenderit, në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit Markat- Ninat dhe rrjeti i brendshëm” dhe “Rruga Janjar-Ninat-Markat”,

4. A.S. ish-inspektori i tokës pranë ish-Komunës Markat, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në tenderët me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit Markat-Ninat dhe rrjeti i brendshëm” dhe “Rruga Janjar-Ninat - Markat”,

5. B.T. ish-jurist në ish Komunën Markat, në cilësinë e hartuesit të dokumenteve të tenderit, në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit Markat-Ninat dhe rrjeti i brendshëm”,

6. K.A. ish jurist në ish-Komunën Markat, në cilësinë e hartuesit të dokumenteve të tenderit, në tenderin me objekt “Rruga Janjar-Ninat- Markat”,

7. E.R. ish-përgjegjës i zyrës urbanistikës, dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në tenderin me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit Markat-Ninat dhe rrjeti i brendshëm” dhe në tenderin me objekt “Rruga Janjar- Ninat - Markat”,

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për:

1. A.B. Drejtor i Urbanistikës në Bashkinë Konispol, në cilësinë e anëtarit të Njesisë Prokurimit (NJP).

2. O.Gj. Inspektor i INUV, në Bashkinë Konispol, në cilësinë e anëtarit të NJP.

3. B.T. me detyrë ish-jurist në ish Komunën Markat, në cilësinë e anëtarit të NJP.

4. **I.B.** me detyrë ish-përgjegjës i Financës në ish Komunën Markat, në cilësinë e anëtarit të NJP.
5. **K.A.** me detyrë ish jurist në ish-Komunën Markat, në cilësinë e anëtarit të NJP.
6. **E.R.** me detyrë ish-përgjegjës i zyrës urbanistikës, dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
7. **I.S.** me detyrë ish-përgjegjës i zyrës së shërbimeve, dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
8. **E.A.** me detyrë ish-ekonomiste në ish Komunën Markat, në cilësinë e anëtarit të NJP.
9. **G.Z.** me detyrë ish-inspektor i zyrës së tatim taksave dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.
10. **A.B.** me detyrë ish financier në ish-Komunën Markat, në cilësinë e anëtarit të NJP.
11. **E.M.** me detyrë ish-përgjegjëse e zyrës taksave, në cilësinë e anëtarit të KVO.
12. **V.G.** në cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës “P...” Shpk, me të cilin është lidhur kontrata për mbikëqyrjen e punimeve në objektin “**Rruga Janjar-Ninat-Markat**”.
13. **Sh.N.** në cilësinë e përfaqësueses ligjore të firmës “N...” shpk me të cilin është lidhur kontrata e punëve publike për objektin “**Rruga Janjar-Ninat-Markat**” Bashkia Konispol, pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe “*Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R